



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 654/3 prot.

Vlorë, më 21 . 05 .2018

VENDIM

Nr. 22, datë 08.05.2018

PËR
RREGULLOREN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË
MATEMATIKË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE,
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

Mbështetur në nenin 33, pika 3, nenin 38, pika 1, shkronja d të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.05.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e programit të studimit të doktoratës në matematikë në Fakultetin e Shkencave Teknike, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Teksti i rregullores ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike, Përgjegjësi i Departamentit të Matematikës, Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" pranë këtij fakulteti.
4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

RREGULLORE


PËR

**ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATURËS NË
MATEMATIKË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**


Miratuar me Vendim nr. 22, datë 08.05. 2018 të Senatit Akademik
të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë

**KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. Roland ZISI**





REPUBLIKA E ALBANI



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

**RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT
"DOKTORATURË" NE MATEMATIKË
FAKULTETI E SHKENCAVE TEKNIKE
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Neni 1

Hartimi dhe përmbajtja e rregullores

Rregullorja "Për organizimin e programit të studimit Doktoraturë në matematikë, Fakulteti i Shkencave Teknike, Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë" është hartuar mbështetur:

- Në ligjin nr. 80/2015, Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112 datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"
- Në Udhëzimin Nr.31, Datë 29.12. 2017 "Për Përcaktimin e Kriterëve, Dokumentacionit dhe Procedurave për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Programeve të Studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë.

1. Rregullorja synon të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për studimet e ciklit të tretë të doktoratës dhe përcaktojë rregulla standarte të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studimeve të këtij cikli.


2. Kjo rregullore i bashkëngjitet statutit të ri dhe shtrin efektet e saj mbi të gjithë njësitë mësimore-shkencore që janë përgjegjëse për organizimin e programeve të studimeve të doktoratës, studentët dhe personelin akademik të këtij cikli.

3. Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor".

4. Programet e studimit të doktoratës organizohen brenda një projekti të madh kërkimor, didaktik, kulturor, kërkimi të pavarur dhe realizohen në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të veprimtarive të kërkimit në fakultet. Objektivat formuese të programeve të studimit të doktoratës duhet të jenë të gjera, të



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES

motivuar dhe të lidhura me orientimet shkencore në fushën e zgjedhur apo në fushat e zgjedhura në rastin e doktoratave të dy ose më shumë disiplinave.

5. Programet përmbajnë veprimtari didaktiko-shkencore të formimit të thelluar teorik, të përvetësimit të metodologjive të kërkimit dhe të teknikave operative të posaçme, të realizuara nëpërmjet moduleve mësimore, seminarëve me kualifikim të lartë, stazhit apo praktikave pranë strukturave të kualifikuara etj. Këto veprimtari duhen përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të lidhen me objektivat formuese të programit të studimit të doktoratës dhe të jenë të kontrollueshëm. Programet përfshijnë kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës, rezultatet dhe mbrojtjen e suksesshme që të çojnë në marrjen e gradës "Doktor".

6. Përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës është Komisioni për Dhënjën e Grades shkencore "Doktor" i ngritur në Njësine Kryesore.

Neni 2

Hapja e programeve të studimit të doktoratave


1. Çdo grup mësimor kërkimor mund të formulojë propozimin për hapjen e programeve të studimit të doktoratës nëse plotëson kushtet konform legjislacionit në fuqi.

2. Koordinator i programit (përgjegjësi i departamentit i cili është me titull akademik i kategorisë "Profesore, (në raste të veçanta dekani i fakultetit ose një anëtar i departamentit personel akademik me kohë të plotë që mban titullin "Profesore ose Profesor i Asociuar"), nëpërmjet Dekanit, i paraqet Komisionit për dhënjën e grades shkencore "Doktor" propozimin për hapjen e programit të ri të studimit të doktoratës ose propozimin për riorganizimin e një programi ekzistues. Ky propozim duhet të formulohet sipas kërkesave të parashikuara: në ligjin nr. 80/2015, Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112 date 23.02.2018 " Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"; Në Udhëzimin Nr. 31 , Datë 29.12. 2017 "Për Përcaktimin e Kriterëve, Dokumentacionit dhe Proçedurave për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Programeve të Studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë

2. Propozimi duhet të shoqërohet edhe me modelet e kontratave të ndryshme të bashkëpunimit, të vlerësimit vjetor të punës së kryer nga studenti, të platformës së doktoraturës dhe të autoreferatit sipas specifikave të çdo fakulteti.



REPUBLIKA E ALBANI



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

3. Komisioni për dhënjen e gradës shkencore "Doktor" brenda një muaji nga data e paraqitjes së programit e shqyrton atë nëse përputhet me kërkesat ligjore të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse ky komision e miraton programin (programet) e paraqitur, dërgohet përmes Dekanit dhe më tej Rektorit për shqyrtimin përfundimtar në Senatin Akademik.


Propozimi i Komisionit për Dhënjen e Grades Shkencore "Doktor" duhet të përmbajë:

- a. fushën shkencore dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës i cili duhet ti referohet një sektori disiplinor ose ndërdisiplinor me relacionin përkatës sqarues;
- b. programin e studimit të miratuar sipas rregullave të parashikuara në statut bashkë me mënyrën e organizimit didaktik dhe shkencor të programit, planin mësimor për fazën e thellimit teorik si dhe parashikime për periudhat e qëndrimit në institucione të huaja kërkimore;
- c. afatet kohore të realizimit të programit të studimit;
- d. tarifën e studimit për çdo student e argumentuar si edhe burime të tjera financimi për studime të doktoratës, nëse ka të tilla;
- e. parashikimi për numrin maksimal të studentëve që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoratës (jo më i vogël se pesë);
- f. personelin akademik që do të mbulojë realizimin e disiplinave teorike të studimit të doktoratës, udhëheqjen e disertantëve sipas titullit apo gradës shkencore. Nëse në ekipet mësimore mund të përfshihet edhe personel akademik i ftuar ai duhet të jetë i miratuar konform statutit të institucioit
- g. të dhëna për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit, njësinë bazë që drejton administrativisht programin e doktoratës kur kjo është ndërdisiplinore;
- h. të dhëna mbi përvojat e mëparshme të strukturave në formime pasuniversitare nëse ka pasur;
- i. bashkëpunimet shkencore për realizimin e programit të studimit apo të pjesëve të tij me institucione të tjera kërkimore ose ente publike apo private;
- j. njësinë apo njësitë bazë propozuese të programit të studimit të doktoratës që garantojnë infrastrukturën e nevojshme, ndërtimore e laboratorike për zhvillimin e programit;
- k. modelin e diplomës.

4. Pas miratimit nga Senati, secili program doktorature (i ri ose i riorganizuar) bashkë me formularët përkatës, të nënshkruar nga përgjegjësi i njësisë



REPUBLIKA E SHQIPERISE



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

propozuese, Dekani dhe Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i dërgohet Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinise për procedurë të mëtejshme.

5. Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, njesite bazë, duhet të paraqesin kërkesën për hapjen e tyre të shoqëruar me dokumentacionin e aplikimit dhe rregulloren për organizimin e programeve të studimit të doktoratave.

6. Programet e studimit të doktoratës quhen të miratuara zyrtarisht kur Këshilli i Ministrave miraton propozimin përkatës të MASR.

Neni 3

Kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve

1. Udhëheqësi shkencor për studentin pjesëmarrës në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin "Profesor", ose "Profesor i asociuar". Udhëheqësi shkencor duhet të jetë i aftë të drejtojë punën kërkimore shkencore të studentëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive kërkimore botuese të tyre, brenda dhe jashtë vendit.

2. Udhëheqësi shkencor propozohet nga njësia bazë dhe përzgjidhet nga Komisioni për dhënjen e grades shkencore "Doktor dhe është personel akademik i disiplinës respektive të studimit të doktoratës. Udhëheqësi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si dhe për zhvillimin e monitorimin e përparimit të punës shkencore të studentit.


- Udhëheqësi shkencor me titullin akademik "Profesor" i punësuar me kohë të plotë udhëheq njëkohësisht jo më shumë se shtate doktorantë
- Udhëheqësi shkencor me titullin akademik "Prof. Asoc" i punësuar me kohë të plotë udhëheq njëkohësisht jo më shumë se pesë doktorantë
- Udhëheqësit e tjerë të punësuar me kohë të pjeshme, udhëheqin jo më shumë se dy doktorantë njëkohësisht.

3. Pranimi i kandidatëve ne programet e studimit te doktoratës do të bëhet duke i'u referuar numrit të kuotave të deklaruar për programin përkatës.

4. Për të kërkuar regjistrimin në programet e studimit të doktoratës studenti duhet të plotësojë këto kritere:



REPUBLIKA E ALBANIËS



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**


- a. të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave", ose cdo diplomë tjetër të vlerësuar të barazvlefshme me të, në fushën e programit të doktoratës apo në një fushë të përafërt të përcaktuar më parë në rregulloren e programit përkatës të doktoratës". Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura dhe të njohsuara nga organet kompetente.
- b. Të ketë notë mesatare të paktën 8 (tetë) në cdo diplomë që zotëron (Për diplomat e universiteteve të huaja për të cilat është bërë njehsimi i saj dhe i rezultateve të edukimit bëhet konvertimi perkates). Komisionit për dhënien e grades shkencore "Doktor ka të drejtën të vendosi kritere të tjera të mesatares në varësi të programit të doktoratës.
- c. Të ketë dëshmi zotërimi të njërës prej gjuhëve të huaja anglisht, frëngjisht, italisht ose gjermanisht të nivelit C1, lëshuar nga mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.
- d. Publikimet në revista në një nga shtetet e BE-së, OECD-së ose G-20, si dhe me referime në konferenca të organizuara në po keto shtete, merren në konsideratë për vlerësimin e kandidatit.

5. Kandidatët konkurojnë në program të studimit të doktoratës me dosje personale e cila duhet të ketë dokumentet e mëposhtme:

- a. Kërkesën e kandidatit drejtuar Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor", ku të theksohet propozimi për temën dhe udhëheqësin shkencor;
- b. CV personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara nëse kandidati ka të tilla.
- c. kopje e noterizuar e diplomave të kërkuara të shoqëruara me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diploma e huaj shoqërohet me vërtetimin e njohjes nga MASR.
- d. kopje e noterizuar e diplomave apo çertifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose çertifikate ekuivalente me to të shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës nëse kandidati disponon një të tillë.
- e. vërtetimin për vazhdimin e programeve të studimit të specializimit së bashku me listën e notave të fituara deri në atë moment nëse kandidati është duke ndjekur një program të tillë.
- f. Fotokopjo të noterizuar të kartës së identitetit ose pasaportës.
- g. Dy fotografi.
- h. Dy rekomandime nga persona me titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar".



REPUBLIKA E ALBANI



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES


- i. dëshmi dhe vërtetime të gjuhës/gjuhëve të huaja sipas kërkesave të përcaktuara më sipër.
- j. deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin.
- k. deklaratë personale e kandidatit që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, sipas përcaktimeve të bëra nga vetë institucioni.
- l. platforma e disertacionit;
- m. Grafiku i punës i ndarë në vite;
- n. vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar;
- o. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurim prej 2000 (dy mijë) lekë.

1. Pas deklarimit të kuotave nga UV dhe verifikimit të standarteve nga MASR për një program studimi doktorate, Njësia Kryesore shpall hapjen e procedurës së aplikimit dhe përcakton datën e fillimit dhe të përfundimit të saj, përgjegjëse për organizimin e këtij programi studimi. Periudha e aplikimeve zgjat dy javë.


2. Pas shpalljes së datës së aplikimeve, Dekani, i përcjellë Komisionit për Dhënjën e Grades Shkencore "Doktor" për miratim propozimet e njesisë bazë për ngritjen e komisioneve ad-hoc pranë çdo departamenti për përzgjedhjen e kandidatëve fitues në përputhje me kriteret e pranimit të vendosura dhe të shpallura publikisht më parë. Anëtarët e komisioneve ad-hoc duhet të kenë të paktën gradën shkencore "Doktor", numri i tyre duhet të jetë tek dhe në varësi të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të departamentit me gradë shkencore. Kryetari i çdo komisioni është përgjegjësi i departamentit vetëm nëse ai ka titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar", në të kundërt kryetar i komisionit zgjidhet një anëtar i Komisionit për Dhënjën e Grades Shkencore "Doktor" dhe përgjegjësi i departamentit është anëtar i komisionit ad-hoc.

3. Aplikimi për regjistrim në programet e doktoratës bëhet me postë drejtuar sekretarive mësimore të njësive kryesore përgjegjëse për organizimin e programit përkatës të doktoratës. Me përfundimin e afatit të aplikimeve dosjet e kandidatëve për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës përcillen në departament për t'u shqyrtuar më pas nga komisionet ad-hoc. Departamenti jo më vonë se një javë pas mbylljes së aplikimeve, në një mbledhje të tij, i miraton ose jo. Përgjegjësi i programit për çdo dosje të kandidatëve fitues plotëson formularët e parashikuar (shih edhe formularët bashkëngjitur kësaj rregulloreje). Gjithashtu dosja duhet të plotësohet dhe me:

- a. vendimin e departamentit për propozimin e tezës.
- b. vërtetim i dekanatit për pranimin e dokumentacionit për aplikim.



REPUBLIKA E ALBANI



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

4. Lista e kandidateve fitues dhe dosjet e plotësuar me propozimin përkatës dhe me formularët e mësipërm i përcillen dekanit e nëpërmjet tij kalojnë për shqyrtim e miratim në Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
5. Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" organizon komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve.
6. Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" jo më vonë se dy javë nga mbyllja e aplikimeve, përzgjedh dhe miraton kandidatet fitues të programit të studimit të doktoratës duke marrë në konsideratë paraprakisht personelin akademik të punësuar me kohë të plotë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe me tej atë të punësuar në të tjera Institucione të Arsimit të Lartë Publik. Listat e kandidatëve fitues shpallet nga Dekani i Fakultetit.
7. Afati i ankimimit është jo më shumë se 5 ditë nga shpallja e kandidatëve fitues nga Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" shqyrton çdo ankimim dhe shprehet me vendim. Vendimi i tij është përfundimtar.
8. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretari për një periudhë një javore nga momenti i marrjes së njoftimit.
9. Kandidatët fitues duhet të paguajnë një tarifë 5000 (pesë mijë) lekë për rregjistrimin në programin e studimit të doktoratës.

**Neni 4
Publikimi**


1. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursat e pranimit në programet e studimit të doktoratës, publikohen në organe të medias së shkruar dhe në faqen zyrtare universitetit, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.

**Neni 5
Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të doktoratës**

1. Pas miratimit të udhëheqjes së doktoratës nga Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", studenti duhet të paraqesë:



REPUBLIKA E ALBANIJE



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES


- a. Projekt-temën, të miratuar nga udhëheqësi shkencor. (modeli bashkëngjitur)
 - b. Progres-raportin e realizimit të temës, në fund të çdo viti akademik, gjatë 3 viteve të studimeve të doktoraturës, të firmosur edhe nga udhëheqësi i temës.
- 2. Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:**
- a. Të ketë realizuar si autor i parë, ose i dytë ku autor i parë është udhëheqësi shkencor së paku, tri referime, dy nga të cilat të jenë në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) i pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në Proceedings, të indeksuar me kod ISBN-je, në vende të OECD-së, BE ose G20.
 - b. Të ketë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku dy prej artikujve duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të njohura të vendeve OECD-së, BE ose G20 me bord editorial ku në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrën të paktën autor i dytë.
 - c. Të ketë mbrojtur gjuhën angleze mbi bazën e testeve ndërkombëtare.
 - d. Të ketë përfunduar gjitha kurset e studimit të doktoraturës, ku të jetë vlerësuar së paku me notën 8 (tetë).
 - e. Të ketë përgatitur dhe paraqitur në Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dosjen e plotë që përmban edhe disertacionin e përfunduar, me një përmbledhje të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Pas shqyrtimit të dosjes, Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" i përcjell dekanit vendimin për vazhdimin ose jo të procedurës së mbrojtjes së doktoratës. Kur Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" vendos pozitivisht, ai vazhdon procedurën e miratimit të jurisë për mbrojtjen e doktoraturës.
 - f. Struktura e disertacionit dhe rregullat për paraqitjen e punimit dhe për literaturën si dhe struktura e përmbledhjes së tij, janë të detyrueshme.
- 3. Të paktën një herë në vit, koordinatori i projektit dhe departamenti apo grupi mësimor shkencor duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së studentit në programin e studimeve të doktoratës. Nëse nga këto analiza arrihet në përfundimin se studenti nuk është i aftë për vazhdimin e mëtejshëm të programit, nëpërmjet dekanatit, mund t'i propozojë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" çregjistrimin e tij nga programi.**

Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e studentit të doktoratës



REPUBLIKA E ALBANI



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

1. Studenti ka të drejtë:

- a. të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e leksioneve dhe të veprimtarive të tjera të parashikuara në programin e studimeve;
- b. të pajiset kundrejt pagesës, me materialet mësimore (tekste dhe leksione të shkruara);
- c. të shfrytëzojë bibliotekën e fakultetit apo të njësisë përkatëse të kërkimit;
- d. të tërhiqet vullnetarisht nga programi duke paraqitur kërkesën me shkrim;

2. Studenti ka për detyrë:

- a. të njohë rregulloren e programeve të studimit të doktoratës dhe bazën ligjore përkatëse (VKM, Udhëzime të MASH etj.)
- b. të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligjet, vendimet, udhëzimet e rregulloret;
- c. të kompletojë programin e miratuar të kërkimit të doktoraturës.
- d. të arrijë rezultate të larta në realizimin e programit të studimeve të doktoraturës.
- e. t'i shlyejë në kohën e duhur Universitetit (fakultetit), të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga regjistrimi dhe vazhdimi i studimeve në programin e doktoratës.
- f. të raportojë, të paktën një herë në vit në njësinë bazë të programit (departament apo grup mësimor shkencor) mbi ecurinë e punës për realizimin e programit.
- g. të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën.
- h. të përfundojë punimin në kohën e duhur.


Neni 7

Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor të studentit

1. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së doktoratës.
2. Të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar.
3. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të kërkimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES


ka përgjegjësi të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.

4. Të mbajë takime të rregullta me studentin mbi ecurinë e punimit.
5. Në rastet e bashkudhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta.
6. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndër marrë veprimet e duhura mbështetëse.
7. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e punës së tij që do të prezantohet në seminare ose takime.
8. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje.
9. Të nxisë studentin që ai të botojë pjesë nga kërkimi i tij, sipas kritereve të vendosura në udhëzim dhe VKM perkatese.


Neni 8

Përgjegjësitë e përgjegjësit të programit të studimit

1. Të hartojë çdo vit një listë me temat që janë në studim.
2. Të kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqësin shkencor. Të respektojë rregullat për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës.
3. Të garantojë se udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës së kërkimit, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij.
4. Të garantojë se udhëheqësit e temave nuk janë të mbingarkuar me udhëheqje diplomash.
5. Të garantojë se kandidatët i plotësojnë standardet për të punuar temën.
6. Të propozojë temat dhe udhëheqësit e punimeve të doktoratës.
7. Të interesohet për t'u siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme.



REPUBLIKA E ALBANI



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

8. Të garantojë se janë respektuar politikat e udhëheqjes.
9. Të garantojë se për zhvillimin e doktoratës zbatohen standardet e kërkimeve shkencore.
10. Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t ka/në kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstatohen probleme, i propozon Komisionit për Dhënjën e Grades Shkencore "Doktor" ndryshimet e nevojshme.
11. Të garantojë se procedura e mbikëqyrjes dhe e shqyrtimit të ecurisë së kërkimit është e rregullt.
12. T'u bëjë studentëve të njohur të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj. që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore.

Neni 9


Afati i përfundimit të studimeve të doktoratës

1. Afati i mbrojtjes së tezës së doktoratës, është 3-5 vjet nga regjistrimi në program. Për arsye të përligjura (sëmundje të rënda, fatkeqësish etj.) kandidati mund t'i kërkojë Komisionit shtyrje të afatit të përfundimit të studimeve të doktoraturës duke paraqitur dhe dokumentuar edhe arsyet e kësaj shtyrjeje.


Neni 10

Procedurat paraprake, formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës

1. Përpara mbrojtjes së doktoratës duhet të respektohet kjo procedurë:
 - a. Kandidati për gradën shkencore "Doktor" me lejen e udhëheqësit paraqet një kërkesë me shkrim dhe dorëzon dezertacionin tek drejtuesi i njesise kryesore, i cili ja pecjell për vlerësim njësisë bazë brenda 15 diteve nga data e dorëzimit.
 - b. Kandidati për gradën shkencore "Doktor", e bën prezantimin e tezës në një mbledhje të hapur që caktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në



REPUBLIKA E SHQIPËRIE




UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES

bashkëpunim me Dekanin, anëtarët e departamentit bëjnë sygjerrime të cilat do t'i vijnë në ndihmë kandidatit. Kandidati brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga mbledhja e hapur mund të bëjë reflektimin e sygjerrimeve dhe vërejtjeve të cilat i konsideron dhe i paraqet në tezën e përfunduar.


- c. Nga njësia bazë, pas vlerësimit dosja dhe disertacioni i përcillet Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" brenda 30 ditëve. Komisioni nqs e vlerëson pozitivisht brenda 30 ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit. Pas vendimit për miratimin e jurisë fillon procedura e mbrojtjes. Juria cakton datën e mbrojtjes brenda 15 ditëve nga formimi i saj. Kandidati mbron disertacionin para jurisë. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ja dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" i cili brenda 10 ditësh merr vendimin për dhënien e gradës shkencore doktor dhe ja përcjell drejtuesit të njësisë kryesore për procedura të mëtejshme.
- d. Kur njësia bazë jep vlerësim negativ për dosjen dhe/ose disertacionin kandidati ka të drejtë ti riparaqesë ato për një periudhë jo më të shkurtër se tre muaj
- e. Dosja duhet të përmbajë:
 - i. Dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për mbrojtjen e doktoratës.
 - ii. Lejen përfundimtare të udhëheqësit për mbrojtje.
 - iii. Tezën përfundimtare.
 - iv. Propozimin e përgjegjësit të programit drejtuar Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" për përbërjen e jurisë për mbrojtjen e doktoraturës.

1. Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5(pesë) anëtarë, ku të paktën dy i përkasin njësisë bazë nga institucione homologe vendase ose të huaja. Anëtarët e jurisë duhet të kenë titullin e kategorisë "Profesor". Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" përcakton dy oponentë, një prej të cilëve duhet të jetë jashtë institucionit. Oponentët janë edhe anëtarë të jurisë për vlerësimin e disertacionit. Ata duhet të kenë titujt akademik të kërkuar dhe veprimtari kërkimore e botuese të pasur, brenda e jashtë vendit, në fushën përkatëse të studimeve, në të cilën ofrohet edhe programi i studimeve të doktoratës.

Një anëtar i jurisë së provimit të doktoratës mund të jetë nga universitete të njohura në botë, për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse, i cili ka, së paku, gradën shkencore "doktor", të fituar në fushën shkencore në të cilën vazhdon studimet doktoranti, dhe mbi 5 (pesë) vjet përvojë



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES

akademike e kërkimore. Oponentët japin vlerësimin me shkrim të disertacionit në jo më pak se 4(katër) faqe format A4 ku saktësohet se punimi në tërësi i përmbush kërkesat e paraqitura në programin e doktoratës, duke i kushtuar vëmendje vlerave origjinale që paraqet punimi si dhe duke u vënë në dukje anët pozitive e negative të tij (nëse ka të tilla).

2. Mbrojtja e doktoratës bëhet me pjesëmarrjen e plotë të jurisë jo më parë se një muaj nga data e miratimit të saj dhe jo më larg se 45(dyzet e pesë) ditë. Data e mbrojtjes përcaktohet nga juria dhe miratohet më vendim të Dekanit, mbi bazën e propozimit të bërë.

3. Kur për arsye të përligjura njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, kordinatori i programit vë në dijeni dekanin, duke i propozuar edhe një datë tjetër për mbrojtje.. Dekani merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas miratimit paraprak nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

4. Në cdo rast të mospranimit të disertacionit, studenti duhet të lajmërohet me shkrim nga Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe Dekani.

Neni 11
Mbrojtja e doktoratës


1. Mbrojtja e doktoratës bëhet si rregull, e hapur, përveç rasteve kur, për natyrën e veçantë të problemeve të trajtuara (sekrete, konfidenciale etj.) Rektori autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar sipas propozimit të Komisionit për Dhenien e Gradës Shkencore "Doktor".

2. Procedura e mbrojtjes së disertacionit përfshin:

- a. paraqitjen nga kryetari i jurisë të dokumentacionit të dosjes, përbërjes së jurisë dhe deklartimit nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes;
- b. paraqitje e temës nga studenti për një kohë prej 25-30 min.;
- c. paraqitje e oponencave;
- d. pyetje nga të pranishmit rreth disertacionit dhe oponencave drejtuar studentit doktorant;
- e. diskutime;
- f. sqarime e replika eventuale nga studenti doktorant dhe udhëheqësi shkencor;



REPUBLIKA E ALBANIËS



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

g. juria i kërkon udhëheqësit të shprehet për punën e kandidatit dhe të japë një vlerësim verbal për kandidatin e cila mund të merret si referencë vlerësimi dhe nga komisioni.

h. Juria përgatit raportin e vlerësimit dhe ja dërgon Komisionit për Dhenien e Gradës Shkencore "Doktor" brenda tre diteve (ditë pune) nga data e mbrojtjes. Raporti i vlerësimit duhet të jetë i qartë, konciz, të shprehi arritjet e temës së doktoraturës, prezantimin, paraqitjen e formatit dhe të dhëna të tjera i shikon të arsyeshme. Këto i behen të ditura kandidatit që gjatë mbrojtjes së disertacionit.

2. Punimi vlerësohet me pikë nga 0 – 100 pikë. 100-80% e pikëve të mundshme = "shumë mirë", 79-60% e pikëve të mundshme = "mirë", 59-40 % e pikëve të mundshme = "mjaftueshëm", 39% e më pak e pikëve të mundshme = "pakalueshëm".

3. Vlerësimi i Jurise i komunikohet kandidatit dhe i përcillet Komisionit për Dhenien e Gradës Shkencore "Doktor" për procedurat e mëtejshme të dhënies së gradës.

4. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" brenda 10 ditësh merr vendimin për dhënien e gradës shkencore doktor dhe ja përcjell drejtuesit të njësisë kryesore për procedura të mëtejshme.

5. Pas mbrojtjes së doktoraturës, autori dorëzon menjëherë një kopje të tij në Bibliotekën Kombëtare dhe një kopje në bibliotekën shkencore të universitetit përkundrejt pajisjes me vërtetim për depozitimin e tyre. Në të kundërt, autorit nuk i dorëzohet diploma përkatëse.


6. Pas realizimit me sukses të mbrojtjes së doktoratës, doktoranti merr gradën shkencore "Doktor i shkencave", diploma firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UV pasi është regjistruar në MASH.

7. Në rast kthimi mbrapsht nga juria, punimi mund të paraqitet për t'u rimbrotur vetëm një herë tjetër përpara së njëjtës juri, jo më parë se 12 muaj nga data e rrëzimit. Për arsye të përligjura si arsye shëndetësore, fatkeqësi familjare të studentit doktorant mbështetur në kërkesën e tij, Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" mund të zgjasë periudhën e mbrojtjes jo më shumë se 12 muaj.


Neni 12

Pezullimi i procedurës së mbrojtjes së doktoratës

1. Nëse doktoranti heq dorë nëpërmjet një sqarimi me shkrim drejtuar Dekanit nga vazhdimi i mëtejshëm i procedurës atëherë mbrojtja konsiderohet e pezulluar.



REPUBLIKA E ALBANIËS



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES

Dekani informon Komisionit për Dhënie të Gradës Shkencore "Doktor", jurinë dhe udhëheqësin mbi pezullimin e procedurës. Në këtë rast është e mundur përsëritja vetëm një herë e procedurës duke marrë parasysh arritjet e doktorantit deri në stadin aktual të procedurës.

2. Procedura e doktoratës do të pezullohet edhe në rastet kur udhëheqësi shkencor jep dorëheqjen për arsye të përligjura si: arsye shëndetësore, rezultatet e arritura nga doktoranti pavarësisht punës së udhëheqësit nuk premtojnë se studenti është i aftë për vazhdimin e mëtejshëm të programit etj.

Neni 13

Revokimi i gradës "Doktor"

Nëse pas mbrojtjes së disertacionit, konstatohet dhe vërtetohet se grada "Doktor" është mbrojtur nëpërmjet falsifikimeve ose në rrugë jo ligjore atëherë grada revokohet, duke vepruar sipas akteve ligjore në fuqi.


Neni 14

Rregullat për paraqitjen e punimit dhe për literaturën


1. Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

2. Tri kopje të punimit shkencor duhet të jenë origjinale. Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit, fakultetit, programit, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes. Pjesa e pasme e kopertinës duhet të përmbajë:

- Një përmbledhje e tij 2000-4000 fjalë në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht.
- Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.
- Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka (shih formatin e pjesës së pasme të kopertinës bashkëngjitur në këtë paketë).



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES

Autoreferati përgatitet në disa kopje nga të cilat anëtarët e jurisë marrin secili nga një kopje.

3. Gjatësia e punimit- Përcaktimi i gjatësisë së punimit bëhet nga njësia bazë sipas specifikave të temës së studimit.

4. Lloji i letrës se përdorur duhet të jetë letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.

5. Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranoen.

6. Teksti duhet të shtypet me hapësirë një ndërmjet radhëve. Hapësira njëshe do të përdoret edhe për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë.

Lloji i shkrimit mund të jetë i punuar në Time New Roman ose shkrimi LaTeX. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she.

7. Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:

- Margjina e sipërme 1"
- Margjina e poshtme 1"
- Margjina e majtë 1.25"
- Margjina e djathtë 1.25"


8. Numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.

9. Standarde të tjera janë:

- Parathënia duhet të shtypet me shkronja kursive.
- Hyrja duhet të ketë numra romakë.
- Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.
- Faqet e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrave të tekstit.
- Shënimet duhen të bëhen në mënyrë kompjuterike.
- Tabelat është mirë të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numri i tabelës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala "tabelë", numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate, referencat duhet të theksohen.



REPUBLIKA E ALBANI



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES


- Diagramet janë një tjetër element i rëndësishëm. Nëse diagramet paraqiten si fotografi, duhet të vendosen në faqen përkatëse, ilustrimet ose grafikët nuk e ndjekin tekstin ose tabelën gjithmonë. Fjala "figurë", numri i diagramës me numër arab dhe shpjegimet duhet të vendosen poshtë diagramës. Përgjithësisht një diagramë nuk duhet të kalojë një faqe. Nëse diagrama vazhdon në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli për tabelat. Si edhe tabelat, diagramet duhet të mblidhen bashkë dhe t'u vihen numra suksesivë. Fotografitë që janë më të vogla se një faqe duhet të vendosen në faqen përkatëse.
- Nëse një punim përmban materiale shoqëruese të tilla, si: disketa kompjuteri, video ose kaseta etj. që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t'i bashkëngjiten punimit.

Neni 15
Mbi etikën e kërkimit

1. Kur dorëzon tezën e përfunduar studenti duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.
2. Një kandidat nuk lejohet të paraqesë si punim një punim që e ka paraqitur më parë në këtë njësi, por kandidati mund të paraqesë pjesë të punës nëse ai tregon qartë cila pjesë e punës është përdorur më parë.
3. Një kandidat mund të paraqesë një pjesë kontributi që është botuar më parë individualisht ose në grup. Nëse puna është pjesë e përpjekjeve të një grupi, një shpjegim për pjesën e shkruar nga kandidati duhet të përfshihet në punim.
4. Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të tjerëve.
5. Përdorimi i ideve ose punës së tjerëve duhet të evidencohet individualisht në tekst ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.
6. Per të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve duhet të shënohet burimi.
7. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore.
8. Nëse burimi origjinal nuk gjendet dot, por ai është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të jepen të dy dokumentet burimi origjinal dhe burimi dytësor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKES**

9. Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur Dekanit për veprime të mëtejshme.

10. Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për një material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës të autorit dhe akte të tjera të palakueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e të drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen që vjen pas titullit të punimit.

Neni 16

Kriteret për përfitimin e gradës shkencore "Doktor" janë në përputhje me:

- Ligjin nr. 80/2015, Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112 date 23.02.2018 "Per percaktimin e kriterëve per fitimin e grades shkencore "Doktor" dhe te standarteve shteterore per fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"
- Udhëzimin Nr. 31 , Datë 29.12. 2017 "Për Përcaktimin e Kriterëve, Dokumentacionit dhe Procedurave për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Programeve të Studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë.
- Ne baze te nenit 134 te ligjit nr. 80/2015 " 1. Studentët, të cilët kanë nisur programet e studimit të doktoratës para hyrjes në fuqi të këtij ligj, i përfundojnë ato sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës kur këta studentë janë pranuar. 2. Përcaktimet e këtij ligji mbi kohëzgjatjen e programeve të studimit zbatohen për studentët që nisin studimet pas hyrjes në fuqi të ligjit. Kriteret që duhet të plotësojnë këta kandidatë janë në përputhje me udhëzimet, VKM në momentin e regjistrimit.

Neni 17

Ndryshimet në këtë rregullore hyjnë në fuqi menjëherë pas vendimit të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për këto ndryshime.